


Vlerësimi i gjendjes trofike të ekosistemeve ujore (liqeneve)

Sasia e klorofilës a konsiderohet sot si një tregues mjaft i përshtatshëm për të vlerësuar gjendjen trofike të fitoplanktonit në mjediset ujore liqenore dhe lagunore. Sipas shumë studimeve sistemi i klasifikimit të gjendjes trofike të lagunave ka katër nivele, nga niveli më i ulët i prodhimtarisë biologjike në më të lartë: oligotrofik, mezotrofik, eutrofik dhe hipertrofik.

Niveli i trofisë së ujrave karakterizon nivelin e algave të fitoplanktonit dhe të lëndëve ushqyese inorganike. Në këtë mënyrë niveli i trofisë jo vetëm karakterizon gjendjen e sistemit ujor po dhe na shërben për të vlerësuar qëllimin e përdorimit të tyre.

Niveli oligotrofik karakterizohet nga ujëra të qarta dhe me nivel të ulët të algave dhe lëndëve inorganike ushqyese, niveli mezotrofik karakterizohet nga ujëra relativisht të qarta po me një nivel mesatar të algave dhe lëndëve inorganike ushqyese, niveli eutrofik karakterizohet nga ujëra me një ngjyrë të gjelbër dhe disi të turbullta si dhe me një nivel të lartë të algave dhe lëndëve inorganike ushqyese, ndërkaq niveli hipertrofik karakterizohet nga një nivel shumë i lartë i algave dhe lëndëve inorganike ushqyese dhe si pasojë qartësia e ujrave është e ulët.

Klasifikimi i gjendjes trofike sipas kriterit Karlson



Fitoplanktoni, si produkti i parë që krijohet nga lënda inorganike dhe energjia diellore me anë të fotosintezës, përbën dhe burimin e parë fillestar për ushqim për kafshët e ujit.

Gjendjet e larta trofike janë rezultat i reduktimit të burimeve të ujrave të ëmbla, ndotjes me lëndë organike dhe inorganike, shkëmbimit të kufizuar të ujit ndërmjet detit dhe lagunave si dhe të erozionit, pra në kushte të caktuara mund të lidhet me nivelin e ndotjes së ujrave për shkak të ndikimit të faktorëve të ndryshëm, vecanërisht antropogjenë.

Klorofila (a) është pigmenti kryesor i fitoplanktoneve, që ka aftësinë “të kapë” energjinë e dritës së diellit dhe të realizojë fotosintezën. Klorofilat i japin mundësi fitoplanktonit të krijojë energji duke shfrytëzuar dritën e diellit gjatë fotosintezës.

Indeksi i gjendjes trofike Karlson sipas përmbajtjes së klorofilit (TSIC) për të katër trupat ujore në periudhën Prill-Qershor 2015

Të dhënat mbi vlerat e parametrin TSIC të nivelit të trofisë për të katër trupat ujore paraqiten në Tabelën 1. Sipas këtyre vlerave bazuar në Kriterin Karlson, në Liqenin e Shkodrës në të tre stacionet e monitorimit vlerat e TSIC për periudhën e pranverës korrespondojnë me nivelin oligotrofik. **(shumë të pastër vlerohet klasa I)**

Në Liqenin e Prespës për të tre stacionet e monitoruara në pranverë 2015 vlerat e treguesit TSIC gjithashtu përshkruajnë gjendje oligotrofike, por tendenca është drejt mezotrofisë. **(shumë të pastër vlerohet klasa I)**

Në Liqenin e Ohrit stacioni 1 përshkruhet si oligotrofik tipik, ndërsa stacioni 2 është në prag të mezotrofisë. Kjo situatë është e spjegueshme duke marrë në konsideratë koordinatat e këtyre stacioneve që korrespondojnë me thellësi pelagjike në rastin e parë dhe zonë litorale në stacionin e dytë. Stacioni i I **(shumë i pastër vlerohet klasa I)** Stacioni II **(Klasa e II)**

Në Lagunën e Butrintit vlerat e TSIC dëshmojnë oligotrofi. **(shumë të pastër klasa I)**

Në të katër trupat ujore situata oligotrofike është e spjegueshme duke marrë në konsideratë periudhën e monitorimit gjatë së cilës ende nuk vihen re lulëzime të popullatave fitoplanktonike, jo vetëm në Ohër dhe Prespë ku temperaturat e pranverës janë më të ulëta, por edhe në Liqenin e Shkodrës dhe Lagunën e Butrintit, të cilat kanë temperaturë paksa më të lartë të ujërave.

Të dhënat mbi vlerat e TSIC të kampioneve të ujrave në të katër ekosistemet ujore.

Muajt	TSIC (Kriteri Karlson bazuar në klorofilën a)		
	Liqeni i Shkodrës Koplik-Bajzë Stërbec AL_LK_102	Liqeni i Shkodrës Zogaj AL_LK_103	Liqeni i Shkodrës Shirokë AL_LK_101
2015			
Prill	26	35,3	34,1

Muajt	TSIC (Kriteri Karlson bazuar në klorofilën a)		
	Liqeni i Prespës Gorricë AL_LK_109	Liqeni i Prespës Liqenas	Liqeni i Prespës Gollomboç
2015			
Maj	35,9	33,5	37,2

Muajt	TSIC (Kriteri Karlson bazuar në klorofilën a)	
	Liqeni i Ohrit Stacioni 1 AL_LK_104	Liqeni i Ohrit Stacioni 2 AL_LK_108
2015		
Maj	28,9	38,5

Muajt	TSIC (Kriteri Karlson bazuar në klorofilën a)
	Laguna e Butrintit AL_LK_801
2015	
Maj	33,2